



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Durrës  
KËSHILLI BASHKIAK

NJOFTIM PËR RENDIN E DITËS  
Mbledhje Rradhës  
Me Mjete Të Komunikimit Elektronik

Në mbështetje të nenit 17, nenit 53, pika 2, të nenit 57 pika 2/c të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të nenit 48, nenit 49 të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, Aktit Normativ të Këshillit Ministrave nr.3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19“, neni 5 “Vendimmarrja nga Organet Kolegjiale,, Këshilli Bashkiak Durrës,

**NJOFTON:**

**DITËN MËRKURË, DATA 31.03.2021, ORA 12:00, KËSHILLI DO TË MBAJË NJË MBLEDHJE TË RRADHËS NËPËRMJET MJETEVE TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK, ME KËTË REND DITE:**

****	MIRATIMI I RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES
1.Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	MIRATIMIN E FONDIT TOTAL PREJ 39’857’100 LEKË PËR RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS ”AZEMHAJDARI”, FSHATI XHAFZOTAJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRASHBULL, RINDËRTIMIN E KALIMEVE(TOMBINO) TË PRISHURA NGA PËRMBYTJET, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KATUNDI I RI, RINDËRTIMINE KALIMEVEQË DO TË PRISHEN NË KANALIN E UJRAVE TË LARTA DHE NDRIÇIMI I RRUGËS ”KRISTO SOTIRI”, NË NJËSINË ADMINISTRATIVENR 4. BASHKIA Durrës
2. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E FONDITPREJ 30 438583 LEKË ME TVSH PËR PËRFORCIMIN E TERRENIT NGA RRËSHQITJA NË ZONAT E NJËSIVE ADMINISTRATIVE NR. 2, NR. 4, RRASHBULL DHE ISHËM
3.	PËR

Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit të këshillit	MIRATIMIN E LISTËS SË PARË PARAPRAKE TË 60 FAMILJEVE, QË KANË HUMBUR SHTËPITË INDIVIDUALE SI PASOJË E SHEMBJES DHE DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË ZONAVE TË REJA
4. Informim Këshilltarëve	PËR PËRDORIMIN E FONDIT PREJ 16 300 268 LEKË TË ALOKUAR NGA BUXHETI I SHTETIT PËR RRRITJEN E PAGAVE PËR FUNKSIONIN E ARSIMIT PARASHKOLLOR
5. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E DISA KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONIN QË VENDOSSET PËR TO NË TERRITORIN E BASHKISË DURRËS
6. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË TRETË TË 76 SUBJEKTEVE PËRFITUESE TË CILËT DO TË PËRFITOJNË MASËN E GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS  26 NËNTOR 2019, SIPAS PROJEKTIT MODEL

Komisionet, që do të shqyrtojnë projektvendimet do të jenë:

Në mbështetje të nenit 5 të Aktit Normativ të Këshillit Ministrave nr.3, datë 15.03.2020, të nenit 33, neni 34/1, neni 77 /8 të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak Durrës, anëtarët e Komisionit të Këshillit Bashkiak **pasi shqyrtojnë me njëri tjetrin elektronikisht** projektvendimin përkatës, dërgojnë me email([roshialneida@yahoo.com](mailto:roshialneida@yahoo.com)) propozimin e tyre (RAPORTIN) mbi projektvendimin sipas grafikut të mëposhtëm.

**DATA 30.03.2021**

**Pika 1, 2, do të shqyrtohet nga:**

- a. Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave
  - b. Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës
- dhe do të sjellin me e-mail Raportin e tyre për këtë projektvendim brenda orës **11.00**.

**DATA 30.03.2021**

**Pika 3, 6 do të shqyrtohet nga:**

- a. Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike
  - b. Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike
- dhe do të sjellin me e-mail Raportin e tyre për këtë projektvendim brenda orës **12.00**.

**Pika 4**, do të shqyrtohet nga:

- a. Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave
  - b. Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit
- dhe do të sjellin me e-mail Raportin e tyre për këtë projektvendim brenda orës **13.00**.

**DATA 30.03.2021**

**Pika 5**, do të shqyrtohet nga:

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor

Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike

dhe do të sjellin me e-mail **Raportin** e tyre për këtë projektvendim brenda orës **14.00**.

**ALNEIDA RROSHI**

**KRYETARE E KOMISIONIT TË RREGULLORES, ÇËSHTJEVE JURIDIKE.**